



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 4, Datë 27.05.2014

PËR

MIRATIMIN E LEJES ZHVILLIMORE TË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN “PALLATI I SPORTIT “ARENA” DHE “GODINA E ADMINISTRATËS SË SPORTIT SHQIPTAR”, BRENDA KOMPLEKSIT SPORTIV “TIRANA OLIMPIK PARK”, ME VENDNDODHJE ISH KLUBI SPORTIV “DINAMO”, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, gërma d) dhe 70/5 të Ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, nenit 12, pika 1, gërma b) të VKM-së nr. 502, datë 13.07.2011 “Për Miratimin e Rregullores Uniforme të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, VKM-së nr. 877, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Sportit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes Zhvillimore të Ndërtimit për objektin “Pallati i Sportit “Arena” dhe “Godina e Administratës së Sportit Shqiptar”, brenda Kompleksit Sportiv “Tirana Olimpik Park”, me vendndodhje ish Klubi Sportiv “Dinamo”, Bashkia Tiranë dhe subjekt kërkues Agjencia e Shërbimeve të Sportit.
2. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
 - a. Dokumenti i Rregullores së Lejes Zhvillimore të Ndërtimit;
 - b. Harta e Planvendosjes së Strukturave të fazës së parë.
3. Formulari i Lejes Zhvillimore të Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njesisë së Qeverisjes Vendore.
4. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

EGLANTINA GJERMEZI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT



ZNJ. LINDITA NIKOLLA

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA

DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

